

## Kushtet e Pjesëmarrjes në Programin e Kujdesit për Fëmijët e Porsaardhur

Fëmija juaj mund të marrë pjesë në një Program të Kujdesit për Fëmijët e Porsaardhur (CNC) vetëm gjatë kohës që ju merrni pjesë në shërbimet e financuara nga Departamenti i Nënshitetësisë dhe Emigracionit të Kanadasë. Ju duhet të jeni të pranishëm në vendndodhje dhe të disponueshëm në rast emergjence.

Programet e CNC-së nuk janë programe provinciale të licencuara të kujdesit për fëmijët. Programet e CNC-së zbatojnë Kërkesat e Programit të Kujdesit për fëmijët e porsaardhur (CNCR) dhe nuk janë të licencuara nga qeveritë provinciale siç janë programet tradicionale të kujdesit ditor për fëmijët, sepse prindërit vetë janë në vendndodhje.

Ju lutemi mos harroni se:

- Ju duhet të jeni prindi i fëmijës për të shfrytëzuar programet e CNC-së.
- Fëmija juaj duhet të jetë të paktën 6 muajsh që të marrë pjesë.
- Ju jeni përgjegjës për të siguruar të gjithë informacionin e nevojshëm për të ndihmuar personelin të kujdeset për fëmijën tuaj.
- Ju duhet të ndodheni në vendndodhje në çdo moment gjatë kohës që fëmija merr pjesë në CNC.
- Ju jeni përgjegjës për fëmijën tuaj dhe duhet të qëndroni në vendndodhje për të ofruar kujdesin në momentin kur nevojitet.
- Nëse largoheni nga vendndodhja e CNC-së në ndonjë moment, ju duhet ta merrni fëmijën me vete.
- Nëse largoheni nga vendndodhja pa e marrë me vete fëmijën, rrezikoni të humbni të drejtën e pjesëmarrjes në programin e CNC-së.

Si prindi, i kam dhënë personelit të gjithë informacionin e nevojshëm për t'u kujdesur për fëmijën tim. E kuptoj se organizata do të marrë të gjitha masat e arsyeshme të sigurisë për ta mbrojtur fëmijën tim. Unë jam dakord që organizatën dhe punonjësit e vullnetarët e saj t'i mbaj jashtë çdo pretendimi, t'i çliroj nga çdo detyrim, përgjegjësi dhe t'i konsideroj të pafajshëm deri në masën e plotë të lejuar nga ligji, duke përfshirë, por pa u kufizuar me, pretendime apo dëmtime që lindin nga pjesëmarrja e fëmijës në këtë program.

Emri i prindit:

Nënshkrimi:

Data:

Emri ISO:

Nënshkrimi:

Data: